



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË POLITIKAVE DHE PROGRAMEVE TË ARSIMIT  
PARAUNIVERSITAR

Nr. 1803 / Prot.

Tiranë, më 05.03 .2026

4  
Lënda: Për njohje dhe zbatim.

**AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Rr. "Aleksandër Moisiu", përballë IKV, Tiranë

**AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT  
PARAUNIVERSITAR**

Rr. "Naim Frashëri", Tiranë

**QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE**

Bulevardi "Zhan D'Ark", Tiranë

**DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Bashkëlidhur, gjeni për njohje dhe zbatim:

- udhëzimin nr. 6, datë 03.03.2026 "Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. 9, datë 3.5.2024 "Për organizimin e testimit të informatizuar të kandidatëve për t'u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar;
- udhëzimin nr. 5, datë 03.03.2026 "Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 14, datë 10.07.2023, "Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

Erzen Tola





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT

Nr. 1803/Prot.  
11

Tiranë, më 03.03. 2026

UDHËZIM

Nr. 5, datë 03.03. 2026

PËR

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 14, DATË 10.07.2023, "PËR  
NUMRIN E NXËNËSVE PËR KLASË DHE NGARKESËN MËSIMORE TË  
PUNONJËSVE ARSIMORË NË INSTITUCIONET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR"**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës "d" të pikës 2, të nenit 26 të ligjit nr. 69/2012. "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe urdhrit nr. 578, datë 11.11.2025. "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit, znj. Orjana Osmani",

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 14, datë 10.07.2023. "Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar", bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:
  - a) Kudo në përmbajtje të udhëzimit, emërtimi "Ministria e Arsimit dhe Sportit" zëvendësohet me "Ministria e Arsimit" dhe akronimi "MAS" zëvendësohet me "MA".
  - b) Kudo në përmbajtje të udhëzimit, togfjalëshi "Arti skenik" zëvendësohet me togfjalëshin "Arte skenike".
  - c) Në pikën 3, të shtojcës 1, për lëndët "Art Pamor", "Muzikë" dhe "Kërcim", te profili i përafërt të shtohet "Arte skenike".
  - d) Në shkronjën "a" të pikës 4 të shtojcës 1, për lëndën "Ekonomi", profili i kërkuar të bëhet "Ekonomi" dhe profili i përafërt të bëhet "Shkenca Sociale".
  - e) Në shkronjën "b", të pikës 4 të shtojcës 1, për lëndën "Arte", te profili i kërkuar të shtohet "Koreografi".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

*Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.*

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT

Nr. 1803 / Prot.  
2

Tiranë, më 03.03. 2026

UDHËZIM

Nr. 6, datë 03.03. 2026

PËR

NJË NDRYSHIM DHE NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 9, DATË 3.5.2024 "PËR ORGANIZIMIN E TESTIMIT TË INFORMATIZUAR TË KANDIDATËVE PËR T'U PUNËSUAR NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 26 të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe urdhrin nr. 578, datë 11.11.2025, "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit, znj. Orjana Osmani",

UDHËZOJ:

- Në udhëzimin nr. 9, datë 3.5.2024 "Për organizimin e testimit të informatizuar të kandidatëve për t'u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar", bëhet shtesa dhe ndryshimi si poshtë:
  - Kudo në përmbajtje të udhëzimit, emërtimi "*Ministria e Arsimit dhe Sportit*" zëvendësohet me "*Ministria e Arsimit*" dhe akronimi "*MAS*" zëvendësohet me "*MA*".
  - Në nenin 12, pas fjalës "*balet*", shtohet togfjalëshi "*arte skenike*".
- Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe njësitë arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

*Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.*

ZËVENDËSMINISTRI  
ORJANA OSMANI

